

FJALA E DEPUTETIT LAVDRIM KRRASHI

E HËNË 31 TETOR 2022

Kolegë dhe qytetarë të dashur,

Vetëqeverisja vendore ose qeveria lokale, bashkia, siç i referohemi në zhargonin e përditshëm, është pjesa më e ndjeshme e nevojave që kanë qytetarët për drejtim, për qeverisje. Si e tillë, struktura, performanca, dinamika për përmirësim të vazhdueshëm ka nevojë që të mbahet gjithmonë në fokusin tonë dhe, në fakt, të të gjithë qytetarëve, kur qytetari përballet me infrastrukturën lokale të papërshtatshme, me shërbëtorë publikë të pasjellshëm apo pa integritet, me parqe të pamirëmbajtuara apo që nuk ekzistojnë fare.

Apo kur përballen me shqetësimin e mungesës së çatisë mbi kokë për ta dhe familjet e tyre, kur shumë anëtarë familjesh jetojnë në një shtëpi apo në një banesë krejt të papërshtatshme për arsye mjekësore apo për arsye të tjera, apo kur për, qytetarët me aftësi ndryshe, shtëpia e tyre, edhe pse ekziston, është kthyer në një burg ose në një ferr, si rezultat i të qenit viktimë e dhunës në familje apo edhe për ata që janë të pamundur. Apo kur nuk ka ujë në çezmat e qytetarëve, në çezmat e familjarëve. Dhe meqë ra fjala, në Dibër, më në fund kemi ujë 24 orë, aq sa, në fakt, qytetarët e Dibrës sot ankohen se presioni është shumë i lartë në çezmat e tyre. Ky është një fat. Ujësjellësi i Dibrës ka siguruar ujë të pijshëm 24 orë për 36 mijë qytetarë që jetojnë në qytetin e Peshkopisë dhe në zonat përreth.

Pra, për çdo rast të përshkruar më lart, por edhe për shumë të tjerë, që për efekt kohe është e pamundur të përshkruhen, dhe shumë shqetësime të tjera, mendja e qytetarëve menjëherë shkon te bashkia, te qeveria lokale, pasi është detyra e saj për t'i adresuar problemet e tyre. Natyrshëm që ka qenë krejt e udhës që ne të rishikojmë si kuvendarë reformën e mëparshme administrative-territoriale për të identifikuar, se unë shoh gotën gjysmë plot, arritjet, por për të parë edhe nevojat, për të ndryshuar. Produkti që kërkohej prej komisionit të posaçëm ishte të shikonte dhe të rishikonte se cila është mënyra më e mirë për t'u dhënë shërbime të mira qytetarëve. Askush nuk ka qenë në mëdyshje, të paktën unë, se rishikim do të thotë që mund të rritet numri i njësive vendore, mund edhe të zvogëlohet, por edhe mund të qëndrojë i njëjtë.

Unë nuk pretendoj për asnjë moment se raporti që propozojmë ne është perfekt, por është më i përshtatshmi në kushtet në të cilat ndodhemi. Pra, komisioni i posaçëm, rishikimi i reformës territoriale-

administrative, nuk është parë si një rast, ku neve si komisionerë, siç referoi edhe një koleg këtu, si anëtarë të komisionit të posaçëm, na ishte dhënë vizore, kompas e mjete të tjera gjeometrike për të rishikuar, për të ndarë Shqipërinë e 28 mijë kilometrave në një Shqipëri më të vogël. Shqiptarët e duan qeverinë vendore të jetë shumë serioze dhe e besueshme. Ata e shohin, e prekin dhe e ndiejnë atë përditë. Natyrshëm, qeveria vendore, njësitë e qeverisjes vendore nuk janë perfekte. Në fakt, janë shumë larg të qenit perfekte, kanë të meta dhe gabime. Të gjithë ne jemi të vetëdijshëm se ndarja në vetvete nuk është perfekte, se ka shqetësime dhe problematika të përditshme në njësitë tona të qeverisjes vendore.

Do të doja fort që ne të kishim një raport të përbashkët. Patjetër që të dy raportet kanë të mirat, kanë edhe mangësitë e tyre. Do të ishte shumë mirë, për qytetarët shqiptarë mbi të gjitha, sikur ne të kishim marrë të mirat e të dy raporteve dhe t'i kishim amalgamuar, meqë fjala "amalgim" përdoret shpesh qysh prej vitit 2014 në Shqipërinë tonë, por kjo nuk ka ndodhur. Përmirësimet e nevojshme do të vijnë me ndryshimin, por nuk jam i bindur se do të vinin me ndryshimin me rritjen e njërive vendore në 94, 97 dhe nuk e di a keni dëgjuar shifra të tjera që janë propozuar. Ato problematika që duhen evidentuar dhe që kanë nevojë të adresohen janë disa, por unë kam listuar 7 problematika, patjetër që mund të ketë edhe të tjera, nuk pretendoj që të jenë krejt ezauruese.

Duhet të ketë konsultim real, publik, me njerëzit në vend të monologëve informativë për ta, apo takime për dialog dhe negociata që nuk duken gjëkund. Duhet monitorim i ngushtë i kompetencave të detyrueshme administrative që kanë njësitë vendore, që janë menaxhimi eficient i shërbimeve publike, bazuar në nevojat lokale, si dhe administrimi i strategjisë kombëtare në funksion të nevojave lokale që kanë qytetarët. Hartim i indikatorëve të performancës, key performance indicators dhe monitorimi i tyre i vazhdueshëm. Duhet asistencë për bashkitë që kanë nevojë për të, jo cilësim si të dështuar sapa ato të hasin në probleme. Gjithashtu, duhet bërë punë e përbashkët nga të gjitha bashkitë.

Duke qenë se unë vij nga eksperiencia e një vendi perëndimor, me të dhëna dhe shërbime publike në rrafshin lokal, nuk e kuptoj sesi njësitë vendore administrative në Shqipëri, nuk mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetër, në të gjitha fushat. Asnjëherë nuk e kam kuptuar se pse të 61 bashkitë kanë, për shembull, drejtori juridike, sepse një shërbim i tillë nuk mund të amalgamohet dhe të jepet nga një grup i posaçëm, nga një drejtori, po themi, për disa njësi vendore dhe jo veç e veç. Po ashtu, ndërveprimi në fusha si strehimi, shërbimi social apo ai i shëndetësisë, ambienti apo infrastruktura, do të krijonte kushte më të favorshme për eficiencë, pasi së bashku rritet fuqia negociuese. Ju falënderoj fort!